



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

Nr. 434 Prot.

VENDIM

Nr. 56 Date 22.10.2018

"Për marrje të nismës për hartimin e P.D.V. në njesinë me kod 1/47 sipas P.P.V."

Mbështetur në autoritetin e Kryetarit te Bashkisë Elbasan dhe në zbatim të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore", në ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin territorit", i ndryshuar me ligjin 73/2015 date 09/07/2015, në VKM nr. 408 date 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar, në VKM nr. 686 datë 22.11.2017 "Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", VKM nr 1096 date 28.12.2015 "Per miratimin e rregullave, kushteve, procedurave përdorimin dhe menzuhimin e hapsirës publike" dhe me PPV të miratuar me vendim te KKT nr.1 date 29.12.2016, dhe interesit të Bashkisë Elbasan:

Për hartim e PDV-së me nismë publike sipas P.P.V. të Bashkisë Elbasan, në njesinë strukturore me kod 1/47. "Qendra e qytetit":

VENDOSA:

- Të marr **nismën** për hartimin, e P.D.V. për njesinë strukturore me kod 1/47, "**Qendra e qytetit**". - qe kufizohet nga bulevardi «Aqif Pasha» ; rrugjet «Qemal Stafa», «Janaq Kılıç», dhe rruga «Rinia». Njësia, që do të studiohet, referuar përcaktimeve në pasaportat e dokumentit të Rregullores Vendore të Planifikimit, figuron me sipërfaqe 65.187,5 m², perimetër 1.176,3 ml.
- Të urdhërojë Drejtoren e Planifikimit të Territorit për hartimin e P.D.V. për njesinë me kod 1/47 "**Qendra e qytetit**", sipas parashikimeve të Relacionit Shoqëruar të Nismës bushkangjitur këtij njoftimi.
- Të urdhërojë Drejtoren e Detyrave të Projektit, Standartizimit dhe Azhomimit të Tokave për hartimin e reliefit topografik të zonës, për njësinë me kod 1/47 "**Qendra e qytetit**".
- Gjatë periudhës së hartimit të PDV, deri në miratimin e saj, ndërtime të reja nuk do të lejohen. Ngarkohet me hartimin, ndjekjen dhe kontrollin e kësaj P.D.V., Drejtoria e përgjithësishme e Shërbimeve Operacionale, Drejtoria e Planifikimit të Territorit të Bashkisë Elbasan.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË

Qazim Sejdini



Relacion Shoqërues për Nismën për Hartimin e PDV për Njësinë Strukturore 1/47

Përbajtja

1- Nevoja për Hartimin e PDV në njësinë Strukturore 1/47	2
2- Baza Ligjore për hartimin e PDV	3
3- Parashikimet e PPV për njësinë strukturore 1/47	8
4- Gjendja e Pronësisë dhe Informaliteti.....	9
5- Plani i Veprimeve për Hartimin e PDV	10
6- Buxheti per për Hartimin e PDV	10
7- Grupi i punes per hartimin e PDV.....	11

Harta 1; 1/1 - Njësia Strukturore 1/47..... 3-4

Tabela 1- Harta e perdonimit te tokes e njësisë Strukturore 1/47..... 8
Tabela 4- Harta e njesise strukturore në GIS 8

Tabela 3- Parashikimet e PPV për njësinë Strukturore 1/47..... 8
Tabela 4- Gjendja e Pronësisë në Njësi 9

1- Nevoja për Hartimin e PDV në njësinë Strukturore 1/47

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkise Elbasan ka percaktuar si zona me intensitet te larte ndertimi njësitet strukturore që ndodhen në qendër të qytetit, ku bën pjesë njësia strukturore 1/47, «*Qëndra e qytetit*», që kufizohet nga bulevardi «Aqif Pasha»; rrugët «Qemal Stafa»; «Janaq Kılıç»; dhe rruga «Rinia». Duke qënë se ndodhet në qendrën e qytetit Zona ka në brendësi të saj dhe shumë monumente kulture dhe një pjesë të Vazhdimit të Zonës Arkeologjike të Kategorisë «A». Në zonë ndodhen dhe disa objekte të kategorisë Monumente Kulture dhe objekte në interes të jetës kulturore të Qytetit. Pjesë e zgjatimit të zonës Arkeologjike «A» të zonës së kalasë është rrënoja e Bazilikës. Monumente Kulture kemi: Rrapi Bezistanit, Hamami, Teatri Skampa, Muzeu Etnografik. Në zonë është ndërtuar së fundmi Xhamia e Ballies. Pjesë e kësaj njësie janë edhe Turizmi i Ri dhe Turizmi i vjetër, Posta dhe Banka Kombëtare Tregtare. Zona ka ndërtimë të reja dhe ndërtimë të vjetra të cilat janë të lëna në degradim. Në zonë ndodhet dhe parku i dytë më i madh i qytetit, i cili shërben si park rekreativ dhe për argëtim. Zona ka një morfologji të çrrregullt si shkak edhe i ndërtimeve të bëra ndër vite, prandaj dhe ndërhyrja në këtë zonë eshte parë si më emergjente për të planifikuar një përdorim më të mirë të tokës por edhe për të zhvilluar qendrën e qytetit.

Për këtë arsy, është mëse e domosdoshme hartimi i PDV-së në këtë zonë dhe për pasojë edhe të jetë në një ndër Planet e Detajuarë Vendore të cilat do të hartohen që në fillim me iniciative të vetë Kryetarit të Bashkisë. Në këtë zonë, sidomos në zonen e godinës së Bashkisë, meqenëse një pjesë e konsiderueshme e pronave janë të sajat, është menduar të zbatohet partneriteti publik-privat për ndërtimin e godinës së re të bashkisë.

Kjo njësi është parashikuar në PPV, që të zhvillohet nëpërmjet PDV, pra si rrjedhojë hartimi i PDV-së shihet si një hap fillestar për vijueshmërinë e projektit.

Harta 1- Njësia Strukturore 1/47,





2- Baza Ligjore për hartimin e PDV

Baza ligjore për hartimin e PDV është Ligji 107/2014, dt 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar dhe VKM nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit. Bazuar në pikat 2, 3, 4, 6, 7, 8, 9, 12, 14 dhe 15 të nentit 22 të ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, PDV:

- Planet e detajuara vendore hartohe me nismë publike ose private në zona të cilat janë:
 - a. një njësi strukturore;
 - b. disa njësi strukturore bashkë;
 - c. çdo zonë me prioritet për zhvillim, e përcaktuar si e tillë në planin e përgjithshëm vendor të territorit.
- Planet e detajuara vendore kanë për qëllim:
 - a) zhvillimin dhe/ose rizhvillimin e një zone;
 - b) rigjenerimin/ripërtëritjen e një zone kryesisht urbane;
 - c) ndërtimin e infrastrukturave publike.
- Planet e detajuara vendore kanë për objekt nëndarjen dhe/ose bashkimin për qëllim zhvillimi.
- Kryetari i bashkisë merr vendimin mbi miratimin e planit të detauar vendor brenda 45 ditëve nga data e paraqitjes për shqyrtim të dokumentacionit të plotë përfundimtar, pasi ka informuar palët e interesuara përmes një a më shumë mjeteve tradicionale të informimit dhe kryen takime publike me ta, në rast se kërkohet.

- Kryetari i bashkisë vendos miratimin e planit të detajuar vendor, bazuar në raportin teknik, të përgatitur nga strukturat përgjegjëse të planifikimit të autoritetit vendor, vetëm në rast se nuk shprehen kundër banoreti qe kane ne pronesi me shumë se një të tretë e sipërafqes së zonës përkatëse të zhvillimit. - Në rast se ka kundërshtime si më sipër, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore organizon takime publike me palët e interesuara, shqyrtion vërejtjet ose propozimet përkatëse dhe vlerëson reflektimin e tyre në planin e detajuar vendor.
- Në përfundim të procesit, kryetari vendos në lidhje me miratimin e planit duke u shprehur edhe në lidhje me pranimin ose mospranimin e propozimeve dhe vërejtjeve të depozituara.
- Plani i detajuar vendor regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme si bazë për kryerjen e transaksioneve me pronën. Parcelat e reja që krijohen nga nënndarja dhe/ose bashkimi i parcelave ekzistuese janë objekt transaksiioni vetëm pasi të jenë regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, me kërkesë të zhvilluesit.
- Dokumenti i planit të detajuar vendor shoqërohet nga një dokument teknik i shpërndarjes së balancuar të të drejtave të zhvillimit, ku përcaktohen edhe raportet e përfitimeve nga zhvillimi, në mënyrë të drejtë dhe proporcionale me kontributin në zhvillim. Përfitimet, kontributi dhe kostot janë financiare ose të mira materiale që përfshijnë të drejtat për zhvillim dhe vlerën e rritur të tokës si rezultat i planifikimit ose investimeve publike.
- Përfitimet e autoritetit të planifikimit nga të drejtat për zhvillim dhe vlera e rritur e tokës përdoren për ndërtimin ose financimin e infrastrukturave publike, kryesisht në zonën ku janë përfshuar.

Bazuar në nenin 70, të VKM "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit":

- Procesi i hartimit PDV-sës nis me botimin e njoftimit të bashkisë në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit të vendimmarries së kryetarit të njësisë vendore.
- Njoftimi përi nisjen e hartimit të PDV-sës përban:
 - o Kodin e Njësisë, të paracaktuar nga Plani i Përgjithshëm Vendor, shoqëruar me përcaktimet për zhvillimin e njësisë që rrjedhin nga ky plan.
 - o Deklaratën e dakordësisë së pronarëve që kanë në pronësi jo më pak se 51% të sipërafqes së njësisë, në rastin e hartimit të PDV-sës me nismë private, në përputhje me pikën 5, të nenit 22 të ligjit.
 - o Sipas vlerësimit të autoritetit përgjegjës për planifikimin, mund të përbujë edhe:
 - ✓ buxhetin për hartimin e PDV-sës, kur është me nismë publike;
 - ✓ planin e veprimit për hartimin e PDV-sës.
- Këshillimi i PDV-sës, në rastet sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 22 të ligjit, kryhet përmes botimit të dokumentit në regjistër, informimit të palëve të interesuara dhe publikut nëpërmjet njësies së zhvillimit, në rast se kërkohet, përmes organizimit të takimeve publike me ta.
- Në çdo rast, dokumentacioni i plotë përfundimtar i PDV-sës botehet në regjistër dhe qëndron i disponueshëm për këshillim të paktën për 30 (tridhjetë) ditë përpura vendimmarrjes së kryetarit.

Ndërkohë bazuar në nenin 71, përbajtja e dokumentit të PDV-sës është:

1. Dokumenti i planit të detajuar vendor (PDV) hartohet në përputhje me dokumentet e Planit të Përgjithshëm Vendor, dokumentet e planifikimit vendor sektorial dhe legjislacionin në fuqi.
2. Plani i detajuar vendor përban të paktën:
 - a. planin e përcaktimeve territoriale, i shprehur në relacion dhe harta shoqëruuese për pikat e mëposhtme:
 - i) analizën që paraprin përcaktimet territoriale;
 - ii) përcaktimin e nënnjësive brenda njësisë në përputhje me nenin 78 të kësaj rregulloreje;


- iii) përcaktimet pér përdorimin e tokës pér çdo nën njësi në nën kategorji qe funksione sipas kësaj rregulloreje;
 - iv) përcaktimet e infrastrukturave teknike, duke përfshirë ato të transportit, energjisë, telekomunikacionit dhe ujësjellës-kanalizimeve;
 - v) përcaktimet e kushteve të zhvillimit pér nën njësitë, sipas rastit dhe/ose pér parcelat;
 - vi) përcaktimet pér zonat/objektet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore, bazuar në legjislacionin përkates në fuqi, sipas rastit;
 - vii) programet e përdorimit të instrumenteve të drejtimit të zhvillimit, bazuar në nenet 30-36 të ligjit, sipas rastit;
 - viii) planin pér zbatimin e PDV-së – ndërtimin e infrastrukturave dhe shërbimeve publike, sipas parashikimeve të PPV-së.
- b. Rregulloren e planit të detauar, ku përfshihen:
- i. përkufizimet e termave të përdorur;
 - ii. shpjegimi i kodeve të përdorura;
 - iii. rregullat, të dhënat dhe kushtet e zhvillimit pér çdo nën njësi, duke detauar rregullat e paracaktuara pér njësinë në PPV, sipas shtojcës II në fund të kësaj rregulloreje;
 - iv. rregulla pér ndarjen dhe bashkimin e parcelave, sipas rastit;
 - v. rregulla pér zbatimin e instrumenteve pér drejtimin e zhvillimit sipas neneve 30-36 të ligjit, sipas rastit;
 - vi. kushtet dhe rregullat teknike pér zbatimin e infrastrukturave;
 - vii. rregullat pér distancat, përcaktimi i vijës së kuqe dhe, sipas rastit, vijës blu;
 - viii) rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe peizazhit;
 - viii. rregullat e ruajtjes së zonave, objekteve të trashëgimisë kulturore, sipas rastit.
 - ix. rregulla arkitektonike;
 - x. rregulla pér përshtatjen e hapësirave pér personat me aftësi të kufizuar.
- c. Informacionin gjeohapësinor të integruar në platformën GIS, në përputhje me standardin e Regjistrat Kombëtar të Planifikimit të Territorit.
3. Dokumenti i planit të detauar vendor shoqërohet nga një dokument teknik i shpërndarjes së balancuar të të drejtave të zhvillimit, ku përcaktohen edhe raportet e përfitimeve nga zhvillimi, në mënyrë të drejtë dhe proporcionale me kontributin në zhvillim. Përfitimet, kontributi dhe kostot janë financiare ose të mira materiale që përfshijnë të drejtat pér zhvillim dhe vlerën e rritur të tokës si rezultat i planifikimit ose investimeve publike.

Neni 72, përcakton përsa i përket miratimit të PDV si më poshtë vijon:

1. Procesi i miratimit të planit të detauar vendor (PDV) bëhet në përputhje me përcaktimet e neneve 22 e 25 të ligjit.
2. Autoriteti përgjegjës pér miratimin e PDVsë është kryetari i bashkisë, në përputhje me shkronjën “dh”, të pikës 1, të nenit 13 të ligjit.
3. Kryetari i bashkisë merr vendimin pér miratimin e planit të detauar vendor, brenda 45 (djzet e pesë) ditëve nga data e paraqitjes pér shqyrtim të dokumentacionit të plotë përfundimtar, pasi ka informuar palet e interesuara përmes RKPT-së, faqes zyrtare të bashkisë, si dhe një a më shumë mjeteve tradicionale të informimit dhe, në rast se kërkohet, kryen takime publike me ta.
4. Kryetari i bashkisë vendos miratimin e planit të detauar vendor, bazuar në raportin teknik, të përgatitur nga strukturat përgjegjëse të planifikimit të autoritetit vendor, vetëm në rast se nuk shprehen kundër banorët që kanë në pronësi më shumë se një të trejtë e sipërfaqes së zonës përkatëse të zhvillimit.

- Në rast se ka kundërshtime si më sipër, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore organizon takime publike me palët e interesuara, shqyrton vërejtjet ose propozimet përkatëse dhe vlerëson reflektimin e tyre në planin e detajuar vendor.
- Në përfundim të procesit, kryetari vendos në lidhje me miratimin e planit, duke u shprehur edhe në lidhje me pranimin ose mospranimin e propozimeve dhe vërejtjeve të depozituara.
- Dokumenti i planit të detajuar vendor hyn në fuqi me botimin e plotë në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit të vendimit të miratimit nga kryetari i bashkisë dhe dokumenteve përbërëse të PDV-së

Harta 2- Harta e perdorimit te tokes per njësine Strukturore 1/47 sipas PPV



Harta 3 – Harta e Njësise Strukturore 1/47 dhe monumentet e kultures ne zone, sipas sistemit GIS



3-Parashikimet e PPV për njësinë strukturore 1/47

Passporta nr.	14
Kodi	147
Zonëimi	PA
Sipërfaqe (m ²)	65137.0
Perimetr (m)	11763
endja ekzistuese	
Përdorimi (K.Bazë) eka.	A. Banz, T. Shkembi, M. Trnagjani dës Muzeumet Kultura dës Historika, TS Institucioni, AK, Aktivitetet sociale dës rikreative, ZN Instruktorë
I (m ² /m ²)	0.04
KSHT (%) eka.	25%
KSHP (%) eka.	14%
KSHR (%) eka.	12%
Propozimi	
Kapaciteti mbajtje:	1736
Nr. përdorues rëtëherbimë	0-0
Përdorimi (K.Bazë) prop.	11. Aktivitetet sociale dës rikreative, 08. Trnagjani dës muzeume kultura dës historika, 01. Banz
% KAT1	30
% KAT2	3
% KAT3	67
Përdorime të tjera të lejuara	infrastruktura arsim, rikreacioni dës gjithë përdorues a para që mëdhaqen kushtet bazu si përdorur të vokat
Përdorimi të adhuruar	Të gjithë me që nuk janë të mbahen
Përdorimi të kohëshëmës	Plaz së karburantit juaj përdorur i kohëshëmës së lojëve e idhurave. Të gjithë me që dominon në vrapë se të ka
Tipologji	HNGjek-Ark&Kultura
Mënyrat e ndryshme:	14. Kompleks
Parcela minimese (m ²)	5000 PDV
Distanca (m)	Signs legjacionar, plaz së lojëve me që dominon
I max. (m ² /m ²) KAT1	Signs projektit
I max. (m ² /m ²) KAT2	Signs legjacionar, plaz së lojëve me që dominon
I max. (m ² /m ²) KAT3	3
KSHT max. (%) KAT1	Signs projektit
KSHT max. (%) KAT2	Signs legjacionar, plaz së lojëve me që dominon
KSHT max. (%) KAT3	50.00%
KSHP max. (%)	50 vites ekzistuese
KSHR max. (%)	10.00%
Sip. Parkimi (m ²)	15213.1
Gjelberim (2.5m ² basar)	6538.0
Gjelberim i përgjithshëm (9 m ² basar)	22819.6
I drejt me lëkure (m ² /m ²)	2
Lartësi max. (m) (jo I me lëkure)	36
Lartësi min. (metri) (jo I me lëkure)	10
PDV	PO
Sip. Min. për PDV (m ²)	E gjithë njëjse
Plaz erëgor para lejei	PA
Tosancat e shëllimit	DNS
Koshe per infrastrukturën ekipamentet dës et njerëz	E ka specifik gjithashtu problemet mëdha që merita qëndra se do t'i dëshironi t'i bëhet qëndra e t'u

4-Gjendja e Pronësisë dhe Informaliteti

Bazuar në të dhënat ZRPP rezulton se sipërfaqja e përgjithshme e njësisë është $65.187,5 \text{ m}^2$. Në këtë njësi kemi të bëjmë me një përzierje midis pronave publike dhe private, te zonave te mbrojtura sic eshte bazilike dhe Rrapi Bezistanit. Tabela e mëposhtme jep shumatoren e përgjithshme të situatës së pronësisë qe perfshihen ne kete PDV:

Harta 4 - Përbledhje e Pronësisë se njësise 1/47



3- Plani i Vepprimeve për Hartimin e PDV-se 1/47

Nr.	Hapat	Përgjegjësitet	Janar [Janet]					Shtator [Shtator]					Mars [Mars]					Prill [Prill]					Maj [Maj]						
			1	2	3	4	5	1	2	3	4	5	1	2	3	4	5	1	2	3	4	5	1	2	3	4	5		
1	Hartimi i Nismës Mezja SH7	Riamond Hadulla																											
1.2	Botimi i Vendimit të Kryetarit për Nismën e PDV	Blerita Zhupa																											
2	Krimi i Databazës																												
2.1	Filevimi Topografik	Maksim Gega																											
2.2	Pronostika në Zonë	Medieli Gega																											
2.3	Projekti Infrastrukturore (ujezjelles, energjikë, telekomunikacion, transport)	Medieli Gega																											
2.4	Ndërtimet ne Zonë	Ildiç Hashigani																											
2.5	Vlerësimi Mëdisor aktual	Inh. Mëdisor																											
2.6	Analiza për PDV	Grupi i punës																											
3.1	Sjellja e Analizom i treguesve të zhvillimit nga PPV	Grupi i punës																											
3.2	Analizimi i infrastrukturave elizistuese	Grupi i punës																											
3.3	Analizimi i aksesit, lëvizjes dhe transportit	Grupi i punës																											
3.4	Analizimi i cilësisë së strukturave dhe teknologjisë	Grupi i punës																											
3.5	Analizimi i ofrimit të shërbimeve publike	Grupi i punës																											
3.6	Kapaciteti mbajtës të zonës	Grupi i punës																											
3.7	Analiza hapiashëse e zonës	Grupi i punës																											
3.8	Analizë i aktorëve të përshtë	Grupi i punës																											
3.9	Analizë sozial-ekonomike e zonës	Grupi i punës																											
3.10	Analiza mbi pronostinë	Grupi i punës																											
3.11	Database GIS gjendje aktuale	Specialist GIS																											
3.12	Degëse Publike	Grupi i punës																											
4	Propozimet e PDV																												
4.1	Koncept zhvillimi i zonës	R.Hadulla, K.Hashigani																											
4.2	Plani i detajuar i përdorimit të tokës	R.Hadulla, K.Hashigani																											
4.3	Plani teknik i shtrire së infrastrukturave të propozuar	R.Hadulla, K.Hashigani																											
4.4	Tipologjia dhe ndërhyrjet e propozuar	R.Hadulla, K.Hashigani																											
4.5	Vlerësimi i Ndikimit ne Mëdisor	Inh. Mëdisor																											
4.6	Programi i zbatimit	R.Hadulla, K.Hashigani																											
4.7	Konsiderata të ndikimit soc-eli nga zhvillimi i propozuar	R.Hadulla, K.Hashigani																											
4.8	Plani i shpërndarjes së treguesve të zhvillimit	R.Hadulla, K.Hashigani																											
4.9	Përgatitja e hartave	R.Hadulla, K.Hashigani																											
5	Studimi i Fizibilitetit																												
5.1	Analiza Financiare	Ekonomi																											
5.2	Plani teknik i ndarjez bashkimit të parcelave	R.Hadulla, S.Haja																											
5.3	Analizë kosto-përfitim per çdo aktor të përfshirë	Ekonomi																											
5.4	Instrumentet Financiare për Zhvillimin e Tokës	R.Hadulla, Ekonomi																											
6	Miratimi																												
6.1	Degëse Publike	Grupi i punës																											
6.2	Reflektimi i komenteve dhe rekomandimeve	Grupi i punës																											
6.3	Miratimi final	Kryetari Bashki																											
6.4	Database GIS PDV perfundimtare	Specialist GIS																											
6.5	Botim ne Register	Blera Zhupa																											
7	Zbatimi dhe Monitorimi	R.Hadulla, E.Koneti																											

4- Buxheti për Hartimin e PDV-se 1/47

Hartimi i PDV do të kryhet me nismë publike dhe do të kryhet nga stafi i bashkisë, përkatesisht nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Drejtoria e Detyrave të Projektit, Standartizimit dhe Azhornimit të Tokave.

5- Grupi punës për Hartimin e PDV-se 1/47

Grupi punës për hartimin e kësaj PDV-je do të përbëhet nga.

Ark. Raimond Hazballa,

Ark. Klajd Haxhihyseni,

Ark. Madielo Gega.

Ing. Top. Eduart Blloshmi

Ing. Top. Maksim Gega

Ing. Top. Fatjona Boja

Ing. Mjedisi

Ekonomist kostoist

Jur. Silvi Harja

Specialist GIS

Monitorim i procesit te hartimit dhe miratimit te PDV-se, nga AKPT.

DREJTORI I DREJTORISE SE PLANIFIKIMIT TERRITORIT

Ark. Raimond Hazballa

DREJTORE DREJTORISE SE PERGJITHESHME E SHERBIMEVE OPERACIONALE

Ing. Etleva Kenuti